



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 - Nr. 400-4738/16
Kaçanik; 15.02.2016

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 61 të Ligjit bazik Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 4 të Ligjit nr.05/L-001.- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, si dhe nenit 34.5 të Statutit të komunës, të nenit 17 alinea 2 e Rregullorës 01Nr. 16-27192/2012- Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më datë **15.02.2016**, merr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE SIPAS BUXHETIT TË
KOMUNËS PËR NË VITIN 2016

1. Me këtë Vendim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2016, i paraparë për Subvencione dhe Transferë të programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, në shumë prej **45,000** euro, do të financon këto projekte dhe aktivitete:

- 1.1. Ndarja e mjeteve për bursa të studimeve universitare, shuma prej **10,000** euro;
- 1.2. Ndarja e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të varrimit ndaj qytetarëve në shumë prej 150 euro për person të vdekur në shumë të përgjithshme prej **23,000** euro;
- 1.3. Mjete për Organizatën Komunale të Veteranëve të Luftës së UÇK-së për mbulimin e shpenzimeve në shumë të përgjithshme prej **2,000** euro;
- 1.4. Mjete me vendime të veçanta individuale të Kryetarit të Komunës deri në 1,000 euro për raste sociale, shëndetësore, emergjente dhe raste tjera të cilat vlerësohen si të domosdoshme në shumë totale prej **10,000** euro.

2. Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës, ndërsa do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhetal Gashi